

community

The New Apostolic Church around the world

02/2024/AI

Në bisedë me Zotin

Kryeartikulli

Rreth lutjes së vërtetë

Shërbesa fetare

Lutja vepron!

Doktrina

Imazhet e Zotit dhe

Zoti i vërtetë

New Apostolic Church
International



■ Kryeartikulli

3 Rreth lutjes së vërtetë

■ Shërbesa fetare

4 Lutja vepron!

■ Këndi i fëmijëve

10 Elia dhe e veja nga Zarpati

12 Për vizitë tek Edwin në Verviers (Belgjikë)

■ Doktrina

14 Perëndia – çfarë shohin njerëzit dhe si është ai në të vërtetë

■ Lajme Globale

18 Udhëheqja, drejtimi i kishës në ndryshimin e brezave

Rreth lutjes së vërtetë



Foto: Neuapostolische Kirche International

Jezusi premtoi: Nëse mblidheni në emrin tim dhe kërkonti në emrin tim, do ta merrni. Sa herë që mblidhemi për t'u lutur në emër të Jezusit, ai është në mesin tonë, duke u lutur me ne.

Kur mblidhemi së bashku në emër të Jezusit dhe i kërkojmë Zotit atë që Jezusi kërkon nga Zoti për ne, atëherë Jezusi lutet me ne. Por: Ne duhet të kërkojmë të njëjtën gjë si ai. Pra, kushdo që lutet: "O Zot, unë dua të jem shumë, shumë i pasur", nuk mund të presë që Jezusi të lutet me të. Sepse Jezusi tha diçka krejtësisht tjetër për paratë dhe të pasurit. Dhe kur lutem: "Jezus, ti duhet ta ndëshkosh armikun tim", nuk mund të pres që Jezusi të lutet po kështu me mua, sepse ai nuk do të pajtohet me këtë. Lutje të tilla nuk dëgjohen sepse nuk pajtohen me lutjen e Jezusit.

Çfarë kërkon Jezusi për ne? Tek Gjoni 17,24 lexojmë: "O Atë, dua që ata që më ke dhënë të jenë me mua kudo që të

jem dhe unë". Nëse duam që lutjet tona të marrin përgjigje, ne duhet të përpiqemi t'i kërkojmë Perëndisë atë që Jezusi kërkon nga Ati i Tij për ne.

Të fala të përzemërta, juaji



Jean-Luc Schneider



Photos: NAK Schweiz

1. Thes 5,17

Lutuni pa pushim

Më 7 janar, apostulli kryesor Jean-Luc Schneider mbajti shërbesën në fillim të vitit në Bazel (Zvicër).

Lutja vepron!

Të dashur vëllezër e motra! Në të vërtetë, kjo është një mënyrë shumë e bukur për të filluar këtë vit të ri. Kjo lutje që kemi bërë të gjithë: "Na trego rrugën drejt lavdisë". Ne kemi një qëllim në jetën tonë, ai është lavdia. Qëllimi ynë nuk është vetëm mirëqenia jonë, lumturia dhe sukcesi ynë. Ne i kemi vënë vetes një objektiv shumë më të madh. Ne duam të hyjmë në lavdi, në shoqëri të përsosur me Perëndinë tonë. Ky është vendimi ynë dhe ky është dhe mbetet synimi ynë në këtë vit të ri. Ne duam të hyjmë në mbretërinë e Perëndisë dhe të bashkohemi me Perëndinë në ditën e Zotit.

Kjo nuk është një ëndërr apo dëshirë: kthimi i Jezu Krishtit nuk është një eveniment, është një fakt hyjnor dhe jo thjesht një premtim që dikush na ka dhënë. Kur Zoti dhe Fryma e Shenjtë flasin për Ditën e Zotit, përshkruhet diçka që është

para syve të tij. Kjo është e vështirë të kuptohet nga ne, si qenie njerëzore, por për Zotin e ardhmja është e tashme, e shkuara është e tashme. Ai ka gjithçka përpara syve. Ai nuk është i lidhur me kohën. Kur ai na flet për kthimin e Jezu Krishtit, ai po përshkruan diçka që ai tashmë e sheh dhe ka ndodhur tashmë për të. Ky është ngushëllimi ynë. Nuk është një premtim i paqartë: ndoshta një ditë do të ndodhë. Nuk e dimë se kur, por është absolutisht e sigurt që do të ndodhë. Prandaj bëjmë këtë lutje: Na trego rrugën si të arrijmë atje? Si mund të marrim pjesë? Fryma e Shenjtë do t'i përgjigjet gjithmonë kësaj lutjeje. Ajo tregon Jezu Krishtin. Jezu Krishti është rruga. Nëse doni të hyni në mbretërinë e Perëndisë, nëse dëshironi të jeni të pranishëm në kthimin e Jezu Krishtit, atëherë duhet të ndiqni rrugën e Jezu Krishtit. Mësimi i tij dhe jeta e tij janë rruga. Ndiqni shembullin e tij dhe ndiqni mësimet e tij. Kështu mund të

përgatitemi për ardhjen e tij të dytë dhe të arrijmë qëllimin tonë. Çfarëdo që të ndodhë vitin e ardhshëm, le të vijmë te Zoti dhe le të lutemi: na trego rrugën. Dhe Fryma e Shenjtë thotë: Shikoni drejt Jezu Krishti. Merruni me Ungjillin e tij dhe zbatoheni atë. Kjo është rruga.

Një pjesë thelbësore e mësimave të Jezu Krishtit është lutja. Lutuni në çdo kohë, lutuni pa pushim. Jezui e shpjegoi këtë në shumë mënyra, si për shembull duke përdorur shembullin e vejushës dhe gjykatësit kur foli për kohët e fundit. Lutuni gjithmonë, mos u dorëzoni në lutje. Kjo është pjesë e atij udhëtimit. Lutja është një pjesë e rëndësishme e përgatitjes sonë për Ditën e Zotit dhe për këtë arsye dhe motoja për këtë vit është: "Lutja juaj është efektive, ajo vepron. Fryma e Shenjtë do të na tregojë këtë rrugë përsëri dhe përsëri. Ajo madje bën më shumë. Ajo jo vetëm që na tregon rrugën, por na jep edhe premtimin: Mos u shqetësoni, unë do të jem gjithmonë me ju në këtë rrugë.

Pali e trajtoi këtë ndryshe. Ai foli për Jezu Krishtin, i cili tani është në qiell në fronin e Perëndisë, duke ndërmjetësuar për ne. Ai është avokati ynë pavarësisht se çfarë ndodh. Ne imagjinojmë se Biri i Perëndisë shkon tek Ati dhe i thotë: Duhet ta ndihmosh tani, të lutem fale. Është pak e vështirë të pajtohet kjo me të kuptuarit tonë për Trinitetin. Ne mendojmë se Ati po bën diçka dhe pastaj Jezusi vjen dhe thotë: Jo, mos e bëj këtë, ki mëshirë për të ose ndihmoje atë. Atëherë Ati do të ndryshonte mendjen dhe qëllimin e Tij, sepse Jezu Krishti u lut për ne. Ne e dimë dhe besojmë se Triniteti, Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Fryma e Shenjtë, janë plotësisht një. Por Pali donte të thoshte: Perëndia do të jetë gjithmonë i gatshëm t'ju ndihmojë dhe t'ju falë. Kur thotë: Jezu Krishti, Biri i Perëndisë, na përfaqëson ne, kjo nuk do të thotë asgjë tjetër veçse: Edhe këtë vit Zoti do të jetë gjithmonë i gatshëm t'ju ndihmojë pa kushte dhe do t'ju falë. Ai është gjithmonë gati dhe është prezent për ju. Këtë do të thotë ai.

Pali tha gjithashtu se Fryma e Shenjtë lutet për ne dhe ndërmjetëson kur ne nuk mund t'i gjejmë fjalët. Fryma e Shenjtë është pjesë e Trinitetit. Kjo nuk do të thotë asgjë tjetër përveç se Zoti e percepton gjithmonë mallin e shpirtit tonë, dhimbjen dhe vuajtjen tonë, edhe nëse ne nuk mund të gjejmë fjalët e duhura. Mund të jemi të sigurt se Zoti ju njeh, Ai e dëgjon lutjen tuaj edhe nëse është vetëm një psherëtimë. Zoti do ta perceptojë gjithmonë atë. Ai është i interesuar se si po kaloni. Ai kupton çdo pikëllim. Për të çdo shqetësim është i rëndësishëm. Ai është gjithmonë aty

për ju. Ai jo vetëm që na tregon rrugën, ai na jep besimin dhe premtimin: Mos u shqetësoni, unë do të jem gjithmonë pranë jush. Unë jam atje për t'ju ndihmuar, për t'ju falur, për t'ju dëgjuar.

Le të kthehemi te motoja: "Lutuni gjatë gjithë kohës". Kjo nuk do të thotë se duhet të lutemi çdo minutë, gjithë ditën dhe gjithë natën. Askush nuk mund ta bëjë këtë. Të paktën jo unë, herë pas here më duhet të bëj diçka ndryshe. "Të lutemi gjatë gjithë kohës" do të thotë që ne të lutemi në çdo situatë. Kjo nuk do të thotë asgjë tjetër përveç se lutja jonë nuk varet nga situata jonë, gjendja jonë, nevojat dhe frika jonë, as nuk përcaktohet nga situata dhe vështirësitë tona: lutja jonë rrjedh nga marrëdhënia jonë me Zotin. Ky është ndryshimi.

Shumë njerëz lutën kur ndihen keq dhe më pas kujtojnë se ka dikë tjetër që mund ta thërrasin. Të lutesh gjatë gjithë kohës do të thotë: Lutja jonë rrjedh nga marrëdhënia jonë

me Perëndinë. Ne lutemi sepse besojmë në Zotin dhe e dimë se ai është i plotfuqishëm. Asgjë nuk është e pamundur për të. Ne besojmë në dashurinë e tij. Ai na do. Ne besojmë se Ai do të na shpëtojë dhe kjo është arsyeja pse ne vazhdojmë të vijmë tek Ai. E duam me gjithë zemër dhe e ndiejmë nevojën të flasim me të, të

vijmë tek ai dhe të shoqërohemi me të në biseda dhe lutje, thjesht sepse e duam. Ne kemi nevojë për këtë kontakt. Lutuni gjatë gjithë kohës, pavarësisht nga situata jonë, por thjesht nga besimi dhe dashuria jonë për Perëndinë. Kjo duhet të jetë baza e lutjes sonë.

Lutja vepron. Lutja është efektive. Kjo mund të na mbajë të zënë gjatë gjithë vitit. Nuk dua ta shtjelloj plotësisht temën, por le të shohim pjesët e ndryshme të lutjes dhe të mendojmë se si mund të funksionojë lutja.

Një pjesë e rëndësishme e lutjes është "adhurimi". Vëllezër e motra, e di që kjo nuk ka qenë gjithmonë pjesë e traditës sonë. Mbaj mend që kjo nuk diskutohej aq shumë kur unë isha adoleshent. Kjo erdhi vetëm më vonë me apostullin kryesor Fehr dhe apostullin kryesor Leber. Ata e përmendën shpesh atë. Adhurimi i Zotit është një pjesë shumë e rëndësishme. Le të gjejmë gjithmonë kohë për të menduar për Zotin dhe për t'u kujdesur për natyrën e tij në vitin 2024. Kjo kërkon pak kohë dhe ju duhet të tërhiqeni pak dhe thjesht të mendoni për të. Kush është Zoti atëherë? Ne jemi të ndërgjegjshëm për gjithëfuqinë e tij. Çfare do të thote ajo? Zoti është krijuesi dhe ai është i gjithëfuqishëm. Zoti është i përsosur, është kaq e lehtë ta thuash, por ka

Zoti do të jetë gjithmonë pranë jush këtë vit.

shumë më tepër për përsosmërinë e Zotit. Ai nuk bën kurrë një gabim. Gjithçka që ai bën është perfekte. Nuk ka nevojë për përmirësim atje. Ajo që ai thotë dhe bën është thjeshtë e përsosur përherë e përgjithmonë: plotfuqia, përsosmëria e Perëndisë, madhështia e Perëndisë, dashuria e Perëndisë. Ai nuk është vetëm dikush që na do. Ai është vetë dashuria. Ai nuk mund të mos dojë, kjo është natyra e tij. Ia vlen të merreni me të intensivisht herë pas here. Kjo ka ndikim edhe tek ne. Na ndihmon të kemi marrëdhënien e duhur me Zotin dhe nga kjo vjen frika dhe respekti ndaj Zotit. Ne bëhemi të vetëdijshëm se sa i madh është ai dhe sa të vegjël jemi ne. Njerëzit që janë kaq të fuqishëm dhe bërtasin aq fort janë shumë të vegjël.

Nga ana tjetër, rritet edhe besimi i thellë tek ai. Zoti është i plotfuqishëm dhe i përsosur dhe ai më do mua. Unë kam arsye për t'i besuar atij plotësisht. Vetëm ky aspekt i "adhurimit" mund ta arrijë këtë tek ne: nga njëra anë, përlësia, frika ndaj Zotit, respekti dhe, nga ana tjetër, besimi ynë dhe besimi ndaj tij. Lutja vepron. Adhurimi është efektiv për ne. Diçka po ndodh në zemrat tona.

Të dashur vëllezër dhe motra, ne nuk duhet ta bëjmë këtë çdo ditë, por le të gjejmë gjithmonë kohë për të adhuruar Zotin dhe për t'u angazhuar me natyrën e tij. Kjo ka një ndikim pozitiv tek ne dhe është një përgatitje e mrekullueshme për kthimin e Jezu Krishtit për ata që e duan Perëndinë, i besojnë Atij dhe e ndjekin Atë me besim.

Një komponent tjetër i lutjes është "falënderimi". Falënderimi është shumë i rëndësishëm. Nuk dua të jap një predikim moral, por ndoshta mund ta falënderojmë Zotin pak më intensivisht këtë vit dhe të vazhdojmë të mendojmë se çfarë na ka dhënë Zoti dhe çfarë ka bërë ai për ne, çfarë po bën dhe do të bëjë. E di që njerëzit priren të shohin gjithmonë së pari atë që nuk patën dhe që ende nuk e kanë, atë që nuk kanë më dhe çfarë u mungon.

Kur lëvizni nëpër botë, kuptoni se pakënaqësia është e pavarur nga gjendja financiare e njerëzve. Ka nga ata që kanë shumë e megjithatë janë vazhdimisht të pakënaqur. Unë shoh njerëz që nuk kanë asgjë dhe janë shumë të lumtur. Përfundimi: Kënaqësia nuk ka të bëjë fare me atë që ne zotërojmë apo jo. Kënaqësia është rezultat i qëndrimit tonë të zemrës. Ka njerëz që kanë shumë dhe nuk janë kurrë të kënaqur. Duke u bazuar nga ana shpirtërore, them: kujdesuni për atë që ju ka dhënë Zoti. Adhurimi do të thotë: Gjithçka vjen nga Zoti dhe nëse çdo gjë vjen nga

Zoti, gjithçka që unë kam më është dhënë gjithashtu prej tij. Mirënjohja për këtë sjell njëfarë gëzimi në zemrat tona që është bërë i rrallë në këtë botë. Ky gëzim krijon kënaqësi dhe gjithashtu siguron ekuilibër mendor. Ne bëhemi më të fortë në jetën tonë. Personi mirënjohës është më i fortë se ai mosmirënjohës; nuk mund ta rrëzoni dot, thjeshtë sepse ai mendon për gjithçka që Zoti i ka dhënë tashmë. Ai është i qëndrueshëm në jetën e tij. Mirënjohja ka një ndikim shumë të madh tek ne dhe bëhet një bekim për ne. Le të gjejmë kohë për mirënjohje këtë vit.

Ne gjithashtu vijmë te Zoti me kërkesat tona. Në këngën e hyrjes, ne kënduam së bashku se ne mund të vijmë te Zoti në lutje për t'i treguar gjithçka atij. Ky mendim më rri në mendje. Ndonjëherë kam frikë se jeta në lutje është pakësuar aty-këtu dhe njerëzit nuk flasin më me Zotin e dashur. Një lutje nuk duhet domosdoshmërisht të jetë në gjunjë, përpara shtratit ose të gjunjëzuar para altarit. Mund të jetë gjithashtu një bisedë në mendjen tuaj ku flisni me Perëndinë. Vëllezër dhe motra, le të përfitojmë nga kjo mundësi për të folur me Perëndinë. Ka kaq shumë që thuhet dhe shkruhet për gjithçka dhe për të gjithë në rrjetet sociale. Po lutja, komunikimi me Zotin? Vëlla, motër, gjithmonë mund të vish

te Zoti dhe t'i thuash çdo gjë atij, absolutisht çdo gjë, pa turp, pa frikë, pa drojtje. Mund të flasim lirshëm për çdo gjë. Qofsh i lumtur, i zemëruar apo i mërziur, kur je i pakënaqur, thjeshtë eja tek Zoti dhe thuaji në mendje dhe në lutje. I dashur Zot, ka diçka me të cilën kam probleme: ai më ka mërziur, ajo më ka fyer, kjo është e padrejtë - thuaji Zotit të dashur për këtë hapur në lutje. Kjo funksionon. Ai ka gjithmonë kohë, fqinji juaj zakonisht nuk ka kohë të të dëgjojë dhe pas pesë minutash e kupton se ai nuk është aspak i interesuar. Zoti i dashur ka gjithmonë kohë. Është shumë ngushëlluese ta dish këtë. Mund të vini tek ai në çdo kohë, pa marrë parasysh nëse ai ka kohë për ju. Ai ju dëgjon dhe ju kupton.

Kur adhurimi dhe mirënjohja bashkëpunojnë së bashku në lutje, kjo arrin diçka. Ne i flasim Zotit, të Plotfuqishmit, të përsosurit dhe të dashurit, duke ditur: Ai më kupton dhe për shkak se është i plotfuqishëm dhe i përsosur, vetë dashuria dhe Shpëtimtari, ai do ta bëjë atë siç duhet. Pra do të më ndihmojë. Ai nuk mund të bëjë gjë tjetër veçse të na ndihmojë, ai dëshiron dhe do të më ndihmojë. Ai e di më mirë se unë çfarë kam nevojë dhe çfarë është më e mira për mua. Adhurimi: Ai është Shpëtimtari. Çfarë dëshiron ai? Ndërsa ndalemi në këtë dhe ia paraqesim shqetësimet dhe



nevojat tona, kuptojmë se Ai dëshiron që unë të jem me Të përgjithmonë. Jezu Krishti dëshiron që unë të jem aty ku është ai. Sa më shumë të merremi me të, aq më shumë arrijmë në përfundimin: I dashur Zot, u bëftë vullneti yt! Këtë e themi jo nga dorëzimi, por nga bindja, madje edhe nga entuziazmi: I dashur Zot, u bëftë vullneti yt. Unë e di se çfarë dëshironi: ju doni të më shpëtoni. Ju dëshironi të më bëni të lumtur përgjithmonë. Ju dëshironi të më çoni në mbretërinë tënde, ku nuk ka më vuajtje, nuk ka më vdekje, nuk ka më dhimbje. Atëherë kjo lutje: U bëftë vullneti yt do të jetë një burim i mrekullueshëm ngushëllimi dhe force. Vijnë te Zoti i dashur, pas adhurimit, pas falënderimit dhe tani flasim dhe i tregojmë çdo gjë që nuk është e mirë dhe ia besojmë atij gjithshka dhe pastaj përgjigja vjen nga Fryma e Shenjtë. Mos harroni se kush është dhe çfarë dëshiron - vullneti i tij u bëftë.

Kur Jezu Krishti ishte në tokë, ai ishte absolutisht i sigurt: Perëndia do të më japë atë që kërkoj prej tij. Ai kishte këtë siguri dhe garanci të mrekullueshme: Çfarëdo që t'i kërkoj Atit, ai do të ma japë. Dhe, kështu ndodhi. Atehere perse? Sepse Zoti Jezus gjithmonë kërkonte atë që Perëndia donte t'i jepte. Thjesht mendoj se kjo ide është fantastike. Perëndia e dëgjonte gjithmonë Jezusin, sepse Jezusi gjithmonë kërkonte prej tij atë që Perëndia donte t'i jepte. Le ta bëjmë edhe kështu. Le t'i kërkojmë Zotit mbi të gjitha atë që dëshiron të na japë: shpëtimin, çlirimin, bekimin. Atëherë jemi të sigurt: Zoti do të na dëgjojë.

Pra, le të vijmë te Zoti me kërkesat, shqetësimet, frikën dhe nevojat tona dhe t'i flasim lirisht atij për to. Ne mund të jemi të sigurt: Ai do të na ndihmojë dhe ndihma e Tij është më e mira që mund të marrim.

Pika e fundit: ndërmjetësimi. Është shumë e rëndësishme në kohën tonë. Ne nuk jemi të verbër. Kur dhim sytë nëpër familjet tona, bashkësitë tona dhe të botës, shohim se shumë njerëz janë në gjendje të vështirë. Para shërbesës, vëllezërit më thanë se ka raste shumë të rënda dhe vëllezër e motra në bashkësi dhe në distrikt janë në hall e në nevojë. Mund të them që vërtet është kështu këtu e kudo dhe kjo më shqetëson shumë. Nuk mund të jesh thjesht indiferent dhe të thuash se kështu është. Çfarë mund të bëjmë ne? Ne mund të lutemi për familjen tonë, për bashkësitë tonë dhe për njerëzit kudo ku janë. Ndërmjetësimi, lutja për tjetrin është diçka shumë e rëndësishme. Ajo është një pjesë shumë e rëndësishme e përgatitjes sonë për kthimin e Jezu Krishtit. Jezusi i merr me vete ata që e ndjekin dhe që bëjnë vullnetin e tij. Vullneti i tij është: Duaje të afërmin tënd si veten, vetëm ky urdhër krijon nevojën për ndërmjetësim. Ne thjesht jemi lutur për veten tonë dhe e duam fqinjin tonë ashtu siç duam veten, ndaj le të lutemi edhe për fqinjin tonë. Edhe ai duhet të jetë mirë. Ne lutemi për të dhe ndajmë mirëqenien dhe shqetësimet, frikën dhe nevojat e tij. Ngaqë e duam, marrim pjesë në fatin e tij dhe vijmë te Zoti dhe lutemi për të. Ky ndërmjetësim, pra kjo lutje funksionon.



Megjithatë dëgjojmë aty-këtu: Po, por jo gjithmonë... dhe unë mund ta kuptoj këtë. Unë kam kërkuar shumë shpesh dhe shumë për vëllezërit e motrat e sëmurë rëndë dhe ata përsëri vdiqën. Zoti i dashur nuk i përmirësoi atyre shëndetin. Mendoj për disa vende ku jam lutur për paqe për dekada dhe gjendja po përkeqësohet. Njerëzit po jetojnë në ankth të madh: I dashur Zot, bëj diçka. Por asgjë nuk po ndodh. Ata vdesin nga uria e kështu me radhë. Pastaj vjen mendimi: ndërmjetësimi është i mirë, por krejtësisht i padobishëm, ai nuk funksionon. Kjo është përvoja dhe mendja njerëzore.

Po kthehem përsëri tek adhurimi. Si e imagjinoni këtë? Ju luteni, bashkësia lutet dhe kur bashkësia lutet, Zoti i dashur bën diçka. Kjo do të thotë se Zoti i dashur ka një plan se si duhet të ndodhë dhe për shkak se ju tani vini dhe luteni, ai ndryshon mendjen dhe planin e tij? Është e vështirë ta thuash këtë. Për shkak se ne lutemi, Zoti i dashur thotë: Sepse ju të gjithë jeni duke u lutur, unë do ta ndihmoj atë dhe do ta kthej situatën. Kjo do të thotë që ne e duam të afërmin tonë më shumë sesa Zoti dhe për shkak se lutemi, Zoti i dashur ndryshon mendjen e tij dhe bën mirë. Përvoja jonë na mëson se ndërmjetësimi, lutja për tjetrin nuk është gjithmonë e dobishme. Mendja jonë thotë: Në besimin tënd kjo nuk është aspak e mundur. Atëherë duhet t'i themi

arsyes dhe përvojës: unë lutem me besim, nuk arrij ta kuptoj, kjo bie në kundërshtim me përvojën time, por megjithatë besoj. Zoti Jezus u lut për ne kur ishte në tokë. Të krishterët e parë u lutën për njëri-tjetrin. Pali thoshte vazhdimisht: Lutu për mua. Nëse do të ishte krejtësisht e padobishme, nuk do të ishte shkruar në Bibël dhe Zoti Jezus, Pali, Pjetri dhe bashkësia në Jerusalem nuk do ta kishin bërë këtë gjë. Prandaj: ndërmjetësimi, lutja për tjetrin funksionon! Është edhe në Bibël. Ne duhet të lutemi për fqinjët tanë dhe këtë e bëjmë me besim tek vetja dhe tek Perëndia. Edhe nëse nuk e kuptoj se si funksionon dhe edhe nëse përvoja ime më thotë të kundërtën, ne lutemi për fqinjin. Për shkak të dashurisë sonë për tjetrin, ne ndiejmë nevojën të lutemi për të. Ky ndërmjetësim funksionon, vepron para së gjithash për ne.

Kur gjejmë kohë për t'u interesuar për personin tjetër, befasisht kuptojmë se ai është shumë më keq se ne, edhe pse ata meritojnë të jenë po aq mirë sa ne. Nuk është një predikim moral, por le të mendojmë pak më thellë për këtë. Kur shohim vëllezërit e motrat tona ose njerëzit në botë, kuptojmë: Ata janë të paktën po aq të mirë sa unë, por nuk e kanë atë që kam unë. Atëherë ti e kupton vërtet se çfarë do të thotë hir apo mëshirë dhe bëhesh edhe më mirënjohës dhe kupton që Zoti më dha këtë apo atë gjë nga hiri, nga



mëshira e tij, jo se e meritoj. Nuk arrij ta kuptoj pse jam unë në këtë gjendje dhe jo të tjerët. I dashur Zot - faleminderit! Kjo na ndihmon të kuptojmë më mirë në fillim se çfarë do të thotë hiri apo mëshira. I lutemi Zotit me mirëbesim, me adhurim. Zoti është dashuria dhe ai e do të afërmin tim ashtu siç më do mua. Ai e di se çfarë po bën dhe do ta ndihmojë edhe atë. Kjo nuk është një eventualitet apo probabilitet - jo, ne arrijmë te siguria: Zoti do të ndihmojë! Kjo siguri na forcon. Ne kemi besim të plotë te Zoti. Ai do të ndihmojë edhe fqinjtim dhe vullneti i tij do të bëhet edhe për fqinjtim. Atëherë kuptojmë se e vetmja zgjidhje për fqinjtim dhe njerëzit tanë është kthimi i Zotit, shpëtimi dhe krijimi i ri. Sa më shumë të shqetësohemi për atë që po ndodh në këtë tokë, aq më e madhe bëhet kjo bindje. E vetmja mënyrë, zgjidhja e vetme është në të vërtetë plani i Zotit për shpëtimin, që Zoti patjetër t'i shpëtojë njerëzit nga kjo e keqe, nga kjo e ligë. Atëherë ju e kuptoni me të vërtetë planin e Perëndisë për shpëtimin dhe përse ai i bën të gjitha këto. Është e vetmja zgjidhje për çdo person që të hyjë në krijimin e ri dhe të jetë në gjendje të jetojë përjetësisht me Perëndinë. Nga kjo nxjerrim përfundime. Është pasojë e ndërmjetësismit për ne: mirënjohje, të kuptuarit më mirë i hirit, mëshirës, besimi tek Zoti se ai do të na ndihmojë dhe përqendrimi në planin e Perëndisë për shpëtimin.

Ndërmjetësimi na ndihmon neve, por ndërmjetësimi i ndihmon edhe fqinjtim tanë. Ne kemi këtë besim dhe premtim nga Zoti: Ai gjithashtu do t'u përgjigjet këtyre lutjeve. Ai do të ndihmojë fqinjtim tonë. Kur njerëzit e dinë se ne po lutemi për ta, është një ngushëllim për ta. Është dikush tjetër që është i interesuar për të dhe që kujdeset për të. Kjo është shumë e rëndësishme, nuk ka më shumë njerëz që e bëjnë këtë. Është ngushëlluese për ata që e dinë se dikush po lutet për mua dhe po merr pjesë në vuajtjet e mia. Ngushëllimi gjithashtu forcon besimin. Ne i besojmë Perëndisë se ai do të ndihmojë dhe kjo e forcon besimin tonë. Pastaj ndodh diçka shumë misterioze. Nuk mund ta shpjegoj, por e përjetoj çdo ditë. Ndiheh sikur po të mbajnë në duar lutjeje. Kjo është një tablo e bukur dhe nuk mund ta shpjegoj me mendjen tënde. Por nëse dikush po e përjeton këtë, jam unë, e di që shumë vëllezër e motra luten për mua. Nuk e di kush, nuk e di sa, nuk e di ku - di vetëm një gjë: ndihem i mbështetur nga lutjet e vëllezërve dhe motrave të mia. Nuk mund ta shpjegoj. Është thjesht një fakt. Unë e di nga shumë vëllezër e motra që gjenden në një situatë të keqe se ndihen të mbështetur nga lutjet e vëllezërve dhe motrave të tyre, pra janë në duar lutjesh. Ndërmjetësimi funksionon dhe ne gjithashtu kemi besim se Zoti do t'i ndihmojë.

Adhurimi, falënderimi, lutja, ndërmjetësimi janë efektive. Le të merremi me intensivisht me të dhe të lutemi së bashku. Kur lutemi së bashku, për shembull tek Ati ynë, kjo forcon unitetin e kishës. Duhet të mendojmë më shumë për këtë. Kur lutemi së bashku, kjo tregon se ne të gjithë jemi të varur nga hiri i Perëndisë. I themi Zotit të tonë të dashur: ki mëshirë për mua. Kjo forcon unitetin. Të gjithë kemi të njëjtin qëllim dhe të njëjtën kërkesë: Më trego rrugën, më forco unitetin. Le t'i kushtojmë vëmendje edhe më të madhe lutjes së përbashkët në të ardhmen. Lutja vepron. Amen.

MENDIME KYÇE

- Fryma e Shenjtë na thërret të lutemi.
- Zoti lutet për ne.
- Lutja në emër të Jezusit kontribuon në shpëtimin tonë.
- Lutja jonë e përbashkët forcon unitetin e kishës..

ELIA DHE E VEJA NGA ZARPATI

SIPAS 1 MBRETERVE 17,1-16

Në Izrael ka thatësi; nuk ka rënë shi për një kohë të gjatë. Zoti e ushqen profetin Elia në shkretëtirë përmes korbave. I sjellin bukë e mish. Elia pi ujë nga përroi i Krithit. Por më pas edhe ky përrua thahet.

Zoti e urdhëron Elian: “Çohu, shko në Zarpat dhe qëndro atje. Në Zarpat është një e ve që do të kujdeset për ty.”

Kështu Elia niset për në Zarpat. Kur Elia vjen te porta e qytetit, sheh një grua që është duke mbledhur dru.

Ai e pyet: “Më sill pak ujë të pi!” E veja largohet. Elia thërret pas saj: “Më sill edhe mua një copë bukë!”

Atëherë gruaja i tha: “Nuk më ka mbetur bukë, vetëm një grusht miell në tenxhere dhe pak vaj në enë. Sapo kam marrë dru



dhe dua të përgatis diçka për të ngrënë për veten dhe djalin tim në shtëpi me sasinë e fundit që kemi. E pastaj na duhet të vdesim.”

Elia i thotë: “Mos ki frikë! Bëni atë që keni dashur të bëni. Por piqni diçka më parë për mua; Më pas duhet të piqni diçka për veten dhe djalin tuaj.

Zoti ju premtan: mielli në enë nuk do të mbarojë dhe kupa e vajit nuk do të mungojë deri sa Zoti të bëjë që të bjerë shi përsëri.”

Ajo bën atë që Elia i tha të bënte. Dhe Elia, e veja dhe djali i saj kanë diçka për të ngrënë çdo ditë: për sa kohë zgjati stina e thatë, patën gjithmonë miell në enë dhe vaji në kupë nuk mbaroi kurrë.

Ashtu siç premtoi Zoti.



PER VIZITE TEK EDWIN NE VERVIERS (BELGJIKE)

Unë quhem Edvin dhe jam pesë vjeç. Jam më i vogli në familje. Unë kam dy motra, Regine, e cila është 15 dhe Brissette 14 vjeç, vëllai im Benjamin është 11. Ne jetojmë në Verviers, që është një qytet në rajonin e Wallonisë në jug të Belgjikës. Belgjika është një vend dygjuhësh: këtu flitet frëngjisht dhe në veri të Belgjikës flitet holandishtja.



Babai im Bernardo është prift dhe drejtues i bashkësisë së Verviers. Emri i nënës sime është Laurette.



Unë kam ndjekur në kishë shkollën e së dielës që kur isha tre vjeç. Kur erdha atje, u shfaqën në Evropë rastet e para me Covid dhe klasa ime nuk u përfshi nga virusi. Kisha frikë se mos infektohesha, por me ndihmën e Zotit, e gjithë familja ime i mbijetoi shëndoshë e mirë pandemisë. Shpesh mendojmë për familjet që kanë humbur dikë dhe për të gjithë ata që janë prekur rëndë nga kjo sëmundje, Zoti i ndihmoftë.



Tashmë jam mjaft i rritur, siç e shihni edhe në foton me babin. Unë e kam kryer shkollën parashkollore me nota shumë të mira dhe tani do të kaloj në shkollën e së dielës që ndjekin edhe dy motrat e mia. Unë tashmë mund të lexoj dhe të shkruaj pak.

Në kohën time të lirë më pëlqen të luaj futboll; Unë kam qenë gjithashtu në stadiumin Bielmont në Verviers.



Ushqimet e mia të preferuara janë makaronat me salcë bolognese, pica dhe Nuggets pule, por edhe makajabu, që është peshk i tharë në kripë.



Në bashkësinë tonë në Verviers kemi një kor të madh fëmijësh. Më pëlqen shumë të këndoj atje; marr pjesë në të gjitha provat e korit.



Zoti – çfarë shohin njerëzit dhe si është ai në të vërtetë

Si mund të ndodhë kështu? Në Testamentin e Vjetër Zoti tregohet i zemëruar dhe në Testamentin e Ri ai është vetë dashuria. Ajo që ka ndryshuar nuk është natyra e tij, por mënyra se si njerëzit e shohin atë. Apostulli kryesor na e bën këtë të qartë në këtë shkrim mësimor.

Si kujdestarë, administratorë të sekreteve të Perëndisë (1 Korintasve 4,1), apostujt kanë për detyrë t'u tregojnë besimtarëve zbulesat e Perëndisë. Njeriu nuk mund ta njohë Zotin vetë. Ne mund të dimë për Perëndinë vetëm atë që ai na ka zbuluar.

Zoti i zbulohet njeriut në mënyrë progresive. Ai e bëri veten të njohur fillimisht si Krijues, pastaj si Zot në historinë e Izraelit. Mishërimi i Perëndisë në Jezu Krishtin është zbulesa e Perëndisë që i tejkalon të gjitha të mëparshmet. Në Rrëshajë, në Pentakost, Perëndia dërgoi Frymën e tij të Shenjtë për t'u zbuluar njerëzve njohuri shtesë për veten dhe planin e tij të shpëtimit. Fryma e Shenjtë vepron edhe sot, veçanërisht nëpërmjet apostulatit, përkatësisht në administrimin e drejtë të shenjtërimeve dhe në shpalljen e drejtë të fjalës. Në kthimin e Krishtit, Perëndia do t'u zbulohet plotësisht atyre që janë tërhequr drejt tij: ata do ta shohin Perëndinë ashtu siç është (1 Gjonit 3,2).

Zbulesat e Perëndisë dëshmojnë në Shkrimet e Shenjta nga njerëz që u frymëzuan nga Fryma e Shenjtë. Autorët e librave biblikë përdorën gjuhën dhe njohuritë e tyre për të përcjellë atë që Fryma e Shenjtë u zbuloi atyre. Në këtë kontekst, duhet të përmendim gjithashtu se shumë nga këto tekste janë shkruar shumë kohë pas ngjarjeve të cilave u referohen.

Raportet rreth Krijimit u shkruan shumë kohë pas ngjarjes për të cilën ata tregojnë; po kështu edhe historia e përmbytjes. Ungjiljet u shkruan gjithashtu dekada pas ringjalljes dhe ngjitjes të Jezu Krishtit në qiell (Luka 1,1-4; Katekizmi i Kishës Apostolike të Re, KNK 1.2.4.1).

Vetëm me ndihmën e Frymës së Shenjtë lexuesi i Biblës mund të njohë vullnetin hyjnor në tekstet e shkruara nga njerëzit. Në veçanti, apostujt, të udhëhequr nga Fryma e Shenjtë, kanë për detyrë të interpretojnë Shkrimet e Shenjta në mënyrë të drejtpërdrejtë për besimtarët, në mënyrë që ata të njohin dhe zbulojnë vullnetin hyjnor.

Zoti në Testamentin e Vjetër dhe të Ri

Testamenti i Vjetër është një përmbledhje e shkrimeve të shenjta nga populli i Izraelit. Mënyra se si autorët e këtyre shkrimeve e përshkruajnë Zotin pasqyron mjedisin kulturor dhe fetar të kohës së tyre. Ata shpesh i atribuojnë Zotit karakteristika njerëzore. Zoti është ofenduar - ofendohet nderi dhe dinjiteti i tij. Ai zemërohet dhe ndëshkon. Ai pendohet - ai pendohet për atë që ka bërë dhe vendos të bëjë diçka ndryshe.

Zoti është i zemëruar me Adamin dhe Evën. Ai u jep atyre një dënim - burri duhet të vuajë për të fituar bukën e tij, gruaja duhet të vuajë kur të lindë, gruaja dominohet nga burri, të dy dëbohen nga parajsja. I zemëruar nga ligësia e njeriut, Perëndisë i vjen keq që krijoi njeriun dhe dëshiron të shkatërrojë gjithçka që krijoi, si njerëzit ashtu edhe kafshët, me një përmbytje (Zanafilla 6,5-7). Të gjitha fatkeqësitë që i ndodhin Izraelit shihen si ndëshkim i vendosur nga Zoti për mosbindjen e njerëzve. Dhe për të ruajtur popullin e Tij, Perëndia mund të tregojë pamëshirshmëri të pabesueshme ndaj armiqve të Izraelit.

Jezu Krishti u zbulon njerëzve natyrën e vërtetë të Perëndisë. Ai flet për një Zot të dashurisë që nuk dëshiron ta ndëshkojë mëkatarin, por përkundrazi dëshiron ta shpëtojë atë. Fatkeqësia që i bie njeriut nuk është dënim i vendosur nga Zoti, por pasojë e sundimit të së keqes. Jezu Krishti është i përsosur, pa mëkat, dhe megjithatë ai duhet të vuajë dhe të vdesë si mëkatarin më i keq, po, si një kriminel.

Testamenti i Vjetër nën dritën e Testamentit të Ri

Jezu Krishti interpretoi shkrimet e shenjta, veçanërisht Torën, librat profetikë dhe Psalmet, për të pasqyruar personin dhe veprën e tij. Nga kjo arrijmë në përfundimin se ne duhet të interpretojmë Testamentin e Vjetër nga këndvështrimi i Birit të Perëndisë. Në KNK 1.2.5.2 thuhet: "Çfarë rëndësie kanë për besimin dhe për doktrinën deklaratat e bëra në librat individualë të Testamentit të Vjetër ose në shkrimet e fundit të tij, përcaktohet nga përshtatja e tyre në përmbajtje me atë që na mëson Ungjilli."

Jezu Krishti thotë shprehimisht se Perëndia nuk dëshiron të ndëshkojë mëkatarin. Prandaj, ne nuk mund ta shohim Zanafillën 3,14-19 si një ndëshkim të caktuar nga Perëndia: vetëm për shkak se ata kishin bërë një gabim, Zoti do të kishte dënuar burrin dhe gruan të vuanin - atë me punë të rëndë dhe ajo në lindjen e fëmijëve dhe vuajtjen e nënshtrimit ndaj burrit. Në dritën e mësimave të Jezusit dhe nën drejtimin e Frymës së Shenjtë, ne besojmë se Perëndia u tregoi Adamit dhe Evës vetëm pasojat e rënies së tyre në mëkat. Meqë ra fjala, nëse nuk do të ishte kështu, çdo iniciativë që synon ta lehtësojë punën do të binte ndesh me vullnetin e Zotit! Mesazhi që nxjerrim nga ky tregim është se Perëndia vazhdoi ta donte njeriun edhe pas keqbërjes së tij dhe i premtoi atij dërgimin e një Shpëtimtari.

Le të vijmë tek përmbytja. Si mund të pendohet Perëndia, i cili është i gjithëdijshëm dhe i përsosur, që krijoi njeriun



sepse ai "zbuloi" ligësinë e tij sipas Zanafillës 6,5? Si do ta eliminonte mëkatën shkatërrimi i shumicës së njerëzve nëse lejon Noeun dhe të afërmit e tij, të cilët janë mëkatarë nga natyra, të mbijetojnë? Fryma e Shenjtë na udhëzon ta shohim historinë e përmbytjes nga këndvështrimi i çlirimit, jo i ndëshkimit (1 Pjetrit 3,18-22). Zoti e do njeriun dhe i jep atij mundësinë që të shpëtohet nëpërmjet bindjes, përluljes ndaj Zotit. I njëjti përfundim vlen për të gjithë historinë e popullit të Izraelit.

Në Dhiatën e Vjetër, shpëtimi kushtëzohej nga bindja, përlulja, e cila kuptohej si respektim i rreptë i ligjit. Jezu Krishti na zbuloi se çfarë është bindja e vërtetë. Perëndia dëshiron që ne të besojmë në Jezu Krishtin dhe ta duam Perëndinë dhe të afërmin tonë.

Testamenti i Ri nën dritën e Frymës së Shenjtë

Ashtu si shkrimet e Testamentit të Vjetër, ato të Testamentit të Ri u shkruan nga njerëz që ishin burgosur në kohën e tyre. Të frymëzuar nga Fryma e Shenjtë, ata përdorën fjalët dhe njohuritë e tyre për të treguar, dokumentuar punën e Jezusit dhe për të regjistruar zbulimet e Frymës së Shenjtë. Ata gjithashtu morën parasysh kulturën e atyre që do t'u adresoheshin, për të qenë të sigurt se ata do të kuptoheshin prej tyre. Në shkrimet e Testamentit të Ri, mesazhi i Ungjillit është gjithmonë i njëjtë, por mënyra në të cilën ai përcillet ndryshon në varësi të shkronjësive dhe marrësit.

Kjo është veçanërisht e vërtetë për mënyrën në të cilën flitet për vdekjen e Jezu Krishtit. Për të shpjeguar

domethënien shpëtuese të sakrificës së tij, autorët biblikë sjellin në mënyrë të alternuar kultin flijues të Testamentit të Vjetër (shlyerjen me para), zakonet e luftës (duhet t'u paguhet një shpërblim që të liroheshin të burgosurit) dhe të drejtën penale (një borxh duhet të shlyhet).

Një interpretim fjalë për fjalë i këtyre teksteve do ta paraqiste Zotin në të njëjtin imazh si në Testamentin e Vjetër. Zoti sillet si një person të cilit i është cenuar nderi dhe dinjiteti. Ai kërkon ndëshkim ose dëmshpërblim. Dikush duhet të vdesë për drejtësi. Jezu Krishti është ai që shlyen për ne.

Kjo pikëpamje për vdekjen e Jezu Krishtit është e vështirë për t'u kuptuar nga të krishterët sot, veçanërisht për të rinjtë. Për fat të mirë, Fryma e Shenjtë na jep mundësinë të flasim për vdekjen e Jezu Krishtit pa e theksuar domosdoshmërisht idenë e ndëshkimit.

Sakrifica e Jezu Krishtit është, mbi të gjitha, një akt dashurie (Gjoni 3,16). Që nga rënia e njeriut në mëkat, njeriu ka jetuar në një distancë nga Zoti. Vuajtjet e tij nuk janë një dënim i vendosur nga Zoti, por pasojë e largimit të tij nga Zoti. Zoti nuk ka pushuar kurrë së dashuri njeriun. Përkundrazi, ai vendosi të bëhet njeri, të vuajë dhe të vdesë për t'i treguar njeriut se është i lidhur me të. Ai nuk dëshiron ta ndëshkojë, por e mbështet në vuajtje, në vdekje dhe madje edhe në mbretërinë e të vdekurve. Ai toleron të trajtohet si keqbërësi, kriminel i më i keq për të treguar se i do të gjithë mëkatarët, pa përjashtim.

Në dashurinë e tij, Perëndia dëshiron t'i udhëheqë njerëzit në shoqëri me veten e tij. Megjithatë, njeriu mund të jetë në bashkësi me Zotin vetëm nëse vullneti i tij korrespondon plotësisht me vullnetin e Zotit. Si qenie njerëzore, Jezu Krishti mbeti pa mëkat. Edhe pse forcat e së keqes u tërbuan kundër tij, ai ishte në gjendje t'i rezistonte tundimit, të ruante besimin te Perëndia dhe të qëndronte i palëkundur në dashurinë e tij. Përsosmëria e tij i mundësoi të hynte në bashkësi me Perëndinë Atë dhe Frymën e Shenjtë si një njeri i vërtetë - jo vetëm si Perëndia Bir. Asnjë person tjetër nuk mund të arrijë përsosmërinë e tij. Por në dashurinë e

Tij, Jezu Krishti është gati të ndajë fitoren dhe meritën e Tij me ata që besojnë në Të dhe që e ndjekin Atë pas. Një mesazh i tillë prek zemrat tona!

Interpretimi i Zbulesës së Gjonit nëpërmjet Apostulatit

Lexuar sipërfaqësisht, "Zbulesa e Gjonit" flet për fundin e botës, zemërimin e Perëndisë dhe ndëshkimin e të ligjve. Fryma e Shenjtë na bën të kuptojmë se ai flet, mbi të gjitha, për fitoren e Krishtit mbi të keqen dhe dashurinë e tij të pakushtëzuar për njeriun.

Zbulesa e Gjonit përfshin zbulesat e Jezusit rreth rrjedhës së ardhshme të planit të shpëtimit dhe i zhvillon ato më tej. Vetë Jezu Krishti njoftoi kthimin e tij. Ai i zbuloi apostullit Pal ngjarjet që lidhen me kthimin e tij (1 Thesalonikasve 4,15-17; 1 Korintasve 1,51, 52). Nën drejtimin e Frymës së Shenjtë, apostujt emërtuan më pas fazat e ndryshme të planit të shpëtimit: ringjalljen e parë, mijëvjeçarin e paqes, gjygin përfundimtar, krijimin e ri.

Misioni i apostujve është të përgatisin besimtarët për kthimin e Zotit. Ata që pranohen do të mund të hyjnë në mbretërinë e tij si fryti i parë. Por çfarë do të bëhet me të tjerët? Për shembull, ata që nuk kanë dëgjuar kurrë për Jezusin? A mund të shpëtohen pa ndjekur Jezusin? Dashuria e Perëndisë do që të gjithë njerëzit të kenë akses në mbretërinë e tij. Drejtësia e tij do që të gjithë të ndjekin të njëjtën rrugë për ta arritur atë: gjithkush

mund të vijë tek Ati, por vetëm nëpërmjet Jezus Krishtit (Gjoni 14,6). Prandaj, të gjithë duhet ta njohin Jezu Krishtin dhe të vendosin ta ndjekin atë. Për këtë qëllim, Jezu Krishti do të vendosë mbretërinë e tij të paqes në tokë. Vetëm kur secili të jetë në gjendje të vendosë lirisht pro ose kundër Jezus Krishtit, Perëndia do ta përfundojë planin e tij të shpëtimit.

Ky mësim është një veçori e kishës apostolike të Re - shumë kisha supozojnë se ardhja e dytë e Jezusit do të shoqërohet nga Gjygi i Fundit. Është për të ardhur keq, sepse ata humbasin një hap thelbësor në planin e shpëtimit i cili dëshmon si dashurinë ashtu edhe drejtësinë e Perëndisë. Ne gëzojmë të ndajmë Ungjillin e Krishtit me shumë të krishterë të besimeve të tjera dhe punojmë me dëshirë me ta për ta promovuar atë. Por ne mbetemi fort të përkushtuar ndaj doktrinës sonë siç dëshmohet në Katekizëm, sepse jemi të bindur se ajo iu zbulua apostujve nga Fryma e Shenjtë.



Masthead

Publikuesi: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zürich/Switzerland

Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany

Editori: Simon Heiniger

Apostujt e distrikteve në mbledhjen e tyre në Pentakost
2023 në Kapstadt (Afrika e Jugut)



Foto: MFP / NAC Afrika e Jugut

Udhëheqja, drejtimi i kishës në ndërrimin e brezave

Në krye të zonave kishtare apostolike të reja ka filluar ndryshimi i brezave: u ngarkuan me detyrë dy ndihmës apostuj distriktesh në vitin 2023 dhe u caktua edhe një ndihmës i ri - plotësisht sipas planit.

Caktimi i shpeshtë me ndihmës apostuj distriktesh ndjek një strategji të qartë: Kërkesat për apostuj distriktesh janë të mëdha, veçanërisht në një botë që po bëhet gjithnjë e më e ndërlikuar, tha apostulli kryesor. Kjo është arsyeja pse ju nuk duhet thjesht t'i hidhni pasuesit tuaj direct në ujë dhe të shihni nëse ata do të dalin me not. Përkundrazi, është e rëndësishme që apostujt e ardhshëm të distrikteve të kenë mundësinë të familjarizohen, të njohin fushën e tyre të punës dhe njerëzit e saj dhe të fitojnë përvojën e tyre të parë të punës së bashku në mbledhjen e apostujve të distriktit.

Në Amerikën e Veriut dhe Amerikën Qëndrore

Një njeri me besim të madh dhe një njeri i dashur, një udhëheqës i urtë dhe një udhëheqës plot guxim - dhe mbi të gjitha një mik, shok i vërtetë: Apostulli kryesor Jean-Luc

Schneider ia dhuroi këtë kurorë dafinash, pra e lavdëroi Apostullin e Distriktit për SHBA Leonard R. Kolb. Pas 50 vitesh në detyrë 67-vjeçari doli në pension në fund të shtatorit.

Zona e tij e punës shtrihej në SHBA, Bahamas, Barbados, Belize, Bermuda, Ishujt Kajman, Kolumbi, Kosta Rika, Dominika, Republika Domenikane, Ekuador, El Salvador, Guatemala, Guajana, Haiti, Honduras, Xhamajka, Meksikë, Nikaragua, Panama, Peru, Saint Kitts dhe Nevis, Saint Lucia, Saint Vincent dhe Grenadines, Trinidad dhe Tobago si dhe në Venezuelë.

Tani përgjegjës për këto vende është John Schnabel. Ish-ndihmësi i apostullit të distriktit u emërua si apostull i distriktit në të njëjtën shërbesë fetare. 59-vjeçari jeton jashtë Nju Jorkut, ka katër fëmijë dhe katër nipër e mbesa dhe me

profesion ishte menaxher investimesh. Përveç anglishtes, gjuhës së tij amtare, ai flet edhe spanjisht.

Në Afrikën e Jugut

Fuqi, forcë udhëheqëse e bashkuar me një përzjerje urtësie, dashurie dhe vendosmërie, besim të fortë dhe besim të madh te Zoti, si dhe gëzim dhe entuziazëm që infektton dhe të tjerët: Kështu u drejtua apostulli kryesor fjalë për fjalë dhe lavdëroi apostullin e distriktit të Afrikës së Jugut John L. Kriel. Kreu i kishës ndërkombëtare e nxori 67-vjeçarin në pension në fillim të dhjetorit pas 46 vitesh në poste të ndryshme.

Ai ishte përgjegjës për Afrikën e Jugut, Botsvanën, Ishujt Falkland, Lesoto, Madagaskarin, Mauritius, Mayotte, Mozambik, Namibia, Réunion, Seychelles, St. Helena dhe Swaziland. Kjo është tani zona e punës e ndihmësit të mëparshëm Peter Lambert, i cili u emërua apostull i distriktit në të njëjtën shërbesë. 59-vjeçari është i njohur përtej zones së tij të punës. Peter Lambert ishte menaxher muzikor i zonave kishtarë të Kepit, pra Afrikës së Jugut nga viti 1989 deri në 2017 dhe shkroi këngë për librin e këngëve dhe dosjen e korit.

Në vitin e Ri

Ndryshime të mëtejshme në krye të kishave të distrikteve apostolike të reja po bëhen tashmë të dukshme:

Thomas Deubel u emërua ndihmës i apostullit të distriktit në shtator 2023. Ai pritet të pasojë apostullin zviceran të distriktit Jürg Zbinden në gjysmën e dytë të vitit 2024. Përveç Zvicrës, zona e përgjegjësisë përfshin Bullgarinë, Gjibraltarin, Italinë, Kubën, Moldavinë, Rumaninë, Sllovakinë, Slloveninë, Spanjën, Republikën Çeke, Hungarinë dhe Austrinë.

Stefan Pöschel u emërua si ndihmës apostul distrikti për zonën e Gjermanisë Perëndimore në dhjetor 2022. Ai është planifikuar të marrë drejtimin e kësaj zone nga Apostulli i Distriktit Rainer Storck në qershor 2024. Kjo zone pune përfshin gjithashtu Shqipërinë, Algjerinë, Angolën, Armeninë, Azerbajxhanin, Belgjikën, Burkina Faso, Francën, Guianën Franceze, Polinezinë Franceze, Gambinë, Gjeorgjinë, Greqinë, Guadelupe, Guinea-Bissau, Iran, Jordani, Kepi Verde, Kosovë, Letoni, Liban, Lituania, Luksemburgu, Mali, Malta, Maroku, Martinika, Mauritania, Kaledonia e Re, Holanda, Antilet Hollandeze, Nigeri, Timori Lindor, Portugalia, Senegali, Surinami, Siria, São Tomé dhe Príncipe, Tunizia, Turqia, Qiproja dhe Egjipti.

Ndryshime në rrethin e apostujve

Vitin e kaluar u bënë 30 emërime apostujsh të rinj dhe 24 apostuj dolën në pension. Ja të gjitha emërimet e apostujve në gjysmën e dytë të 2023:

Në shërbesën më 2 korrik në Luanda (Angola), apostulli kryesor Jean-Luc Schneider emëroi bishopin e mëparshëm Ricardo Kiaku Simão (1987) si apostull. Më 16 korrik, në shërbesën në Kinshasa (Republika Demokratike e Kongos), tre vëllezër admin. morën postin e apostullit: prifti Giresse Mata Manzala (1984), prifti Roger Nzambiwisi Ndonga (1972) dhe bariu Henri Tshetshe Ngoy Ngoy (1974). Të tre punojnë në zonën e punës së Apostullit të Distriktit Michael Deppner.

Në Neunkirchen (Gjermani) më 30 korrik, apostulli kryesor emëroi evangjelistin e mëparshëm të distriktit Carsten Denker (1972) si apostull. Ai punon për zonën e kishës të Gjermanisë Perëndimore. Reto Keller (1965) merr përsipër zonën e ndihmës apostullit të distriktit Thomas Deubel. Bishopi i mëparshëm u emërua apostull në shërbesën e 17 shtatorit.

Në Buenos Aires (Argjentinë), apostulli kryesor emëroi si apostull evangjelistin e distriktit Pedro Ramis (1973) dhe bariun Omar Pablo Piñeyro (1969). Apostulli i distriktit Rainer Storck fitoi dy apostuj të rinj më 29 tetor: Bishopët René Follmann (1978) dhe Gerd-Günter Kisselbach (1970) u emëruan si apostuj në shërbesën në Bad Sassendorf (Gjermani).



Photo: NAK Schweiz

Pasqyra

- 04.04.2024 Buenos Aires (Argjentinë)
- 05.04.2024 Buenos Aires (Argjentinë)
- 07.04.2024 Montevideo (Uruguay)
- 03.05.2024 Cuando Cubango (Angola)
- 05.05.2024 Luanda (Angola)
- 12.05.2024 Borkum (Gjermani)
- 19.05.2024 Luzern (Zvicër)
- 31.05.2024 Dili (Timori Lindor)
- 02.06.2024 Dili (Timori Lindor)
- 04.06.2024 Denpasar (Indonezi)
- 07.06.2024 Papua-Guinea e Re
- 09.06.2024 Papua- Guinea e Re
- 23.06.2024 Niederrhein (Gjermani)
- 28.06.2024 Harare (Simbabwe)
- 30.06.2024 Mzuzu (Malawi)

New Apostolic Church
International

